



L A J M E

RRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE

Më datë 11.04.2023, në kuadër të planit të ri strategjik për forcimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, zhvilloi trajnimin e dedikuar për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafëve përgjegjëse të sigurisë kibernetike të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit në vend.

Trajnimi u zhvillua në dy sesione paralele, ku një sesion konsistonte në trajnimin e Infrastrukturave të reja Kritike dhe të Rëndësishme të informacionit të identifikuar në vitin 2022. Këto infrastruktura të reja u njohën me kuadrin ligjor në fuqi për sigurinë kibernetike, rëndësinë e ngritjes së CSIRT sektorial, përgjegjësitë e CSIRT kombëtar/ CSIRT sektorial, procesin e identifikimit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, kategorizimi i incidenteve kibernetike, si dhe rëndësi e veçantë ju kushtua shpjegimit të masave të sigurisë kibernetike, që duhet të implementojnë Operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit.

Sesioni i dytë paralel, konsistoi në zhvillimin e disa ushtrimeve praktike “*Table Top Exercise*”, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga infrastrukturat ekzistuese kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të cilët përmes diskutimeve dhe pjesëmarrjes aktive mbi skenarë të ndryshme, arritën në konkluzione mbi rëndësinë e hartimit të procedurave të sigurisë, rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të stafëve teknike si dhe fazat e parandalimit dhe detektimit të sulmeve të mundshme që mund të afektojnë infrastrukturat TIK.

